



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS
SENATI AKADEMIK

Nr. 5711 Prot.
12

Tiranë, më 05.04.2022

VENDIM
Nr. 35, datë 05.04.2022

**PËR NJË NDRYSHIM DHE KORRIGJIM NË VENDIMIN 81, DATË
07.05.2021 “PËR NGRITJEN E KOMISIONIT TË SIGURIMIT TË
STANDARTEVE TË CILËSISË, BOTIMEVE DHE PROJEKTEVE
SHKENCORE”**

Në zbatim të neneve 38 (pika 1, germa “i”), 46 (pika 3) të Ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në IAL e RSH”, të neneve 20 (germa “nj”), 26 (pika 3, germa “b”) të Statutit të UST- së, në nenet 7, 10 të Rregullores së UST-së, bazuar në Procesverbalin e mbajtur gjatë votimit të datës 07.05.2021, Senati Akademik i UST-së në mbledhjen e datës 05.04.2022,

VENDOSI:

1. Të shfuqizojë pikën 3 të Vendimit të Senatit Akademik nr. 81 datë 07.05.2022 “Për ngritjen e Komisionit të Sigurimit të Standarteve të Cilësisë, Botimeve dhe Projekteve Shkencore” si të papasqyruar drejt sipas Procesverbalit të mbledhjes së Senatit të datës 07.05.2021.
2. Të korrigjohet riemërtimi i komisionit të përhershëm institucional nga “Komisioni i Sigurimit të Standarteve të Cilësisë, Botimeve dhe Projekteve Shkencore” në “Komisioni i Kërkimit, Projekteve dhe Botimeve Shkencore”, sipas Statutit të UST-së, miratuar me Urdhërin nr. 25, dt.26.01.2022 të Ministrisë të Arsimit dhe Sporteve, në Universitetin e Sporteve të Tiranës me këtë përbërje:
 - 1) *Prof.Dr. Dhimitraq Prifti* Anëtar nga FSHL
 - 2) *Prof.Dr. Robert Çina* Anëtar nga FSHR
 - 3) *Prof.ASc.Dr. Arben Kaçurri* Anëtar nga IKSHS
 - 4) *Prof.ASc.Dr.Fisnik Brovina* Anëtar nga IKSHS
 - 5) *Prof.ASc.Dr.Ferdinand Mara* Anëtar nga FVFR
 - 6) *MSc. Mirlinda Galushi* Anëtar Administratori i UST-së
 - 7) *Esmeralda Beshi* Anëtar Studente
3. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I SENATIT AKADEMIK

PROF.DR. AGRON KASA

